



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191176

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05588921

KPPP.nr. 1437/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit DLD Group Sh.p.k., me numër unik identifikues 810841636 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian” nr. 25, Pejton, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti, avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, rr. “UÇK” - 2, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 615/23 të datës 24.08.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbaremore P.nr. 615/23 i datës 24.08.2023, i lejuar nga Përmbareues Privat Irfan I. Kërçagu dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbaremore.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit DLD Group Sh.p.k., ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr. 615/23 të datës 24.08.2023 duke lejuar përmbaremin mbi bazën e dokumentit Faturë me numër 2022/0031 të datës 01.11.2022 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës të lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1833.33 EUR (njëmijë e tetëqind e tridhjetë e tri euro e tridhjetë e tre cent), shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbaremi në vlerë prej 104.00 EUR (njëqind e katër euro), dhe shpenzimet e për përgjigjen në prapësim në vlerë prej 104.00 EUR (njëqind e katër euro), si dhe

shpenzimet tjera që mund të rrjedhin gjatë procedurës. E të gjitha këto kërkesa të cekura më lartë të paguhen me kamatë prej 8% në pajtim me LMD, që nga data e paraqitjes së propozimit për përmbnim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbnimor duke theksuar se urdhri për përmbnim i lëshuar nga përmbnuesi privat është i pabazuar, si i tillë është i palejuar dhe i paqëndrueshëm, kjo për faktin se e njëjta Faturë me nr.2022/0031 e datës 01.11.2022, vlera 1833.33 EUR është paguar nga ana e debitorit, duke e bashkangjitur edhe raportin e listës së kuponit të shpenzimeve sipas numrit të kuponit. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të abrogohet Urdhri Përmbnimor P.nr. 615/23 i datës 24.08.2023 i lejuar nga Përmbnuesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbnimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është në tërësi i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbnim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbnuesit Privat në shumën prej 1833.33 € është përmbushur në tërësi nga debitori. Ky fakt vërtetohet nga raporti i listës së shpenzimeve sipas numrit të kuponit 2022-332947 e datës 24.11.2022 e bashkangjitur nga debitori në prapësim, nga e cila rezulton se debitori e ka përmbushur në tërësi borxhin që rrjedh nga fatura 2022/0031, duke bërë pagesë në vlerë prej 1833.33 EUR.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet në rast se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbnues ose urdhri përmbnues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, u vendos si në dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbnimore, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbnimore”*.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1437/23 datë 18.04.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.